



OBSERVATORI PËR TË DREJTAT E FËMIJËVE

Bulevardi "Bajram Curri", Pall "Agimi", Shk 5, Ap 81, Tiranë

Tel: 00355 4 258 987 | e-mail: info@observator.org.al | www.observator.org.al

SITUATA E REFUGJATËVE TRANZIT DUKE KALUAR NGA KUFIJTË E SHQIPËRISË- INFORMACIONI I MBLEDHUR NGA EKSPERTËT E 12 ZYRAVE RAJONALE TË OBSERVATORIT

Neësletter- Nr 1, 27 Gusht 2015

Bazuar në ngjarjet e fundit në të cilën vendet e Bashkimit Evropian janë duke u ballafaquar me procesin e emigrimit të refugjatëve sirianë, dhe në bazë të informatave që këta refugjatë janë duke kaluar nga kufiri shqiptar për të arritur në destinacionin e vendeve të BE-së, Observatori për të Drejtat e Fëmijëve ndërmori nismën për të mbledhur informacion nga të 12 zyrat që veprojnë në nivel rajonal në të gjitha qarqet e Shqipërisë në lidhje me këtë situatë. Informacioni është mbledhur nga shumë burime në nivel qendror dhe lokal dhe ishte më specifike nga rajonet kufitare të Shqipërisë.

Duke mbledhur informacion nga 12 zyrat, zyrat qendrore e Observatorit kontaktoi me drejtorin e Drejtorisë për Qytetarët dhe Refugjatët në Ministrinë e Punëve të Brendshme, Znj Alma Mele. Ajo rekomandoi për kontaktimin e Policisë kufitare dhe Ministrinë e Punëve të Jashtme për të marrë informacion për këtë çështje. Bazuar në këtë rekomandim, ekspertët e Observatorit kontaktuan Policinë kufitare për të marrë informacion në lidhje me këtë situatë.

Në rajonin e Korçës, eksperti Observatori kontaktoi kreun e Policisë kufitare dhe ai i dha informacionin që ata kanë nuk patur raste të azilkërkuesve që kanë kaluar kufijtë e Shqipërisë në Kapshticë për të arritur shtetet e tjera. Ata kishin vetëm një rast të një familje shqiptare, që donte të kalonte kufijtë e Kapshticës për të emigruar në Gjermani.

Observatori në Gjirokastrë raportoi se bazuar në informacionin e Drejtorisë Rajonal Kufitare dhe Emigrimit në Gjirokastrë, ata kanë pasur raste të azilkërkuesve që kalojnë nga kufijtë e Gjirokastrës. Kjo situatë u zhduk para dy muajsh, kur familjet shqiptare ishin duke kërkuar të kalonin kufijtë për të marrë azil në Gjermani.

Eksperti i Observatorit në Fier ka kontaktuar me Drejtorinë e Policisë në Qarkun e Fierit duke bërë të ditur se nuk kishin informacion për refugjatët tranzit.

Eksperti i zyrës së Observatorit në Dibër ka kontaktuar me inspektorin e pikës kufitare Z. Defrim Merdini, i cili ka pranuar se ata nuk kishin raste të refugjatëve tranzit në pikat kufitare Blata dhe Trebishta.

Eksperti i Observatorit në Kukës ka kontaktuar me drejtorin e pikës kufitare Z. Xhevdet Axhami. Ai informoi se në 3pikat kufitare të Qarkut të Kukësit nuk janë regjistruar raste të azilkërkuesve transit.

Observatori për të Drejtat e Fëmijëve do të marr informacion periodik nga 12 zyrat në Shqipëri në lidhje me këtë situatë të refugjatëve tranzit.